



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.15/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Kryetarja e gjykatës Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të parashtruar nga ana e ankuesit Sh.Sh., nga Prizreni, ndaj gjyqtarës N.B.:, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës C.nr.2279/21, në bazë të së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me dt.22.08.2023 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ankuesit Sh.Sh., nga Prizreni, ndaj gjyqtarës N.B.:, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës C.nr.2279/21.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës Sh.Sh., nga Prizreni ka parashtruar Urgjencë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës ndaj gjyqtarës N.B.:, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm -Divizioni Civil, lidhur me lëndën civile C.nr.2279/21. Kjo urgjencë nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës është përcjellë në Gjykatën Themelore në Prizren si Kërkesë për shqyrtim të çështjes për shkak të zvarritjes së procedurës dhe mos caktimit të seancës nga ana e gjyqtarës N.B.:, .

Ankuesi Sh.Sh., në Ankesën e tij (Urgjencë) pretendon se në lëndën civile C.nr.2279/21 e cila është caktuar tek gjyqtarja N.B.:, është në cilësi të palës së paditur, pala paditëse është I Gj.Sh., dhe lënda e kontestit është vërtetim pronësie. Kërkesa e tij ka qenë që lënda të caktohet pasi që nga dt.30.11.2022 kur është mbajtur seanca e fundit ku është vendosur për masën e sigurisë (i është refuzuar kundërpadia dhe është vendosur për Kërkesën për caktim të masës së sigurisë nga ana e Gjykatës së Apelit) nuk është caktuar asnjë seancë tjetër.

Gjyqtarja N.B.:, në deklaratën e saj në lidhje me pretendimet e ankuesit ka cekur se pranë kësaj gjykatë është parashtruar padia e paditëses I. Gj.Sh.,) nga Prizreni zë cilën e përfaqëson av. A.J.:, kundër të paditurit Sh.Sh., nga Prizreni të cilin e përfaqëson av. A.Sh., për shkak të vërtetim

të pronësisë. Fillimisht kjo lëndë ka qenë në punë tek gjyqtari A.H., i cili edhe ka ndërmarr veprime në këtë çështje. Më pas me dt. 17.08.2022 lënda i është caktuar gjyqtarës N.B., pasi që gjyqtari i mëparshëm është avancuar. Gjyqtarja ka cekur se kur e ka pranuar lëndën ka vërejtur se ka Propozim për caktim të masës së sigurisë të propozuar nga ana e paditëses I.HGJ.-Sh., për të cilën ka mbajtur dy seanca dëgjimore, ka vendosur për këtë propozim me Aktvendim duke e refuzuar të njëjtën i cili vendim është vërtetuar nga ana e Gjykatës së Apelit me Ac.nr.8906/2022 e dt. 16.01.2023. Pasi që ka vendosur për masën gjyqtarja lëndën e ka vendosur në pritje pasi që sipas Strategjisë së Këshillit Gjyqësor lëndët e kësaj natyre nuk janë me prioritet gjithashtu kjo lëndë nuk është më e vjetër se 2 vite e paraparë sipas strategjisë . Gjithashtu gjyqtarja ka cekur se pala Sh.Sh., ka tentuar që disa herë të vjen në zyre tek ajo dhe pasi që nuk e ka pranuar me një rast kur ajo nuk ka qenë në zyre ai ka hyrë dhe përkundër kërkesës së zyrtarës që të largohet nuk e ka liruar zyrën . Konsideron se i njëjti është duke bërë presion në mënyra të ndryshme për caktim të lëndës. Gjyqtarja konsideron se si gjyqtare gjykuese nuk mundet të caktojë lëndën e cila mban numrin C.nr.2279/21 para lëndëve që janë më të vjetra se kjo lëndë sepse atëherë me veprimet e saja do të shkel të drejtat e qytetarëve të tjerë që kanë lëndët më të vjetra në pritje , ashtu që caktimi i kësaj lënde pa radhë do të përbënte shkelje nga ana e saj.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar ankesën-urgjencën drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka iniciuar hetimet preliminare për procedurë disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shikimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar deklaratë nga gjyqtari i çështjes N.B., ka bërë verifikimin e shkresave të lëndës C.nr.2279/21. Pas vlerësimit dhe analizës së tërësishme të provave të mbledhura Autoriteti Kompetent konsideron se:

Ankesa është e pabazuar.

Autoriteti kompetent - Kryetarja pas verifikimit të gjithë dokumentacionit ka vërtetuar gjendjen faktike si vijon:

Ankuesi parashtruesi i urgjencës ka vërejtje në punën e gjyqtarës N.B., lidhur me lëndën civile C.nr.2279/21 për shkak të zvarritjes së lëndës dhe mos caktimit të seancës. Me shikimin në shkresa të lëndës është vërtetuar se lënda C.nr.2279/21 është për shkak të vërtetimit të pronësisë me propozim për caktim të masës së sigurisë sipas padisë së paditëses I.Gj-Sh., nga Prizreni me përfaqësuesin e autorizuar av. A.J.; nga Prizreni kundër të paditurit Sh.Sh., nga Prizreni të cilin e përfaqëson av.A.Sh., Padia është dorëzuar në gjykatë me dt. 26.10.2021.Lënda fillimisht i është caktuar gjyqtarit A.H., i cili ka ndërmarr veprime në këtë lëndë dhe më pas është avancuar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme . Lënda më pas i është dorëzuar gjyqtarës N.B., me dt. 17.08.2022 me Aktvendim nga ana e Kryetarës. Duke pasur parasysh se me padi ka qenë e parashtruar edhe Propozimi për caktim të masës së sigurisë gjyqtarja ka caktuar seancën dëgjimore me dt.24.22.2022 dhe 30.11.2022 ku ka vendosur për propozimin e paditëses për caktim të masës së sigurisë duke e refuzuar si të pabazë. Ka pasur ankesë ndaj këtij vendimi dhe të njëjtën e ka vërtetuar Gjykata e Apelit me Ac.nr.8906/22. Më pas ka pasur disa urgjenca nga ana e të paditurit këtu ankuesit dhe një kundërpadi me dt. 13.06.2023.

Autoriteti Kompetent konsideron se gjyqtarja i ka ndërmarr veprimet të cilat janë të parapara me prioritet, pra ka vendosur për propozim të masës së sigurisë në afatin ligjor , kurse për pjesën tjetër të kërkesëpadisë do të vendosi sipas radhës. Sipas Planit Strategjik për Përmirësim të Qasjes në Drejtësi 2022-2025 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës janë përcaktuar se cilat lëndë kanë prioritet në punë gjatë këtij viti, si lëndë me prioritet janë lëndët më të vjetra se 2 (dy) vjet,

lëndët e kthyerë në rigjykim, lëndët e dhunës në familje, lëndët civile statusore. Lënda për të cilën ankuesi pretendon se ka zvarritje nuk bën pjesë në asnjë grup të këtyre lëndëve. Pjesa që ka të bëjë me prioritet, respektivisht për Propozim për masën e sigurisë është vendosur dhe është zgjidhur kjo çështje andaj si Autoritet Kompetent konsideroj se gjyqtarja N.B.; në veprimet e saja nuk ka pasur shkelje të cilat konsistojnë me shkeljet disiplinore të parapara me Ligjin për Përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Për arsyet që u cekura më lartë, Autoriteti Kompetent — Kryetarja e Gjykatës ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.15/23, me dt. 22.08.2023



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, nuk e parapare e drejta e ankesës.